



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.03.2019, ora 12:00 – 13:30

Drejton mbledhjen:

**Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit
dhe kryetar i grupit “Miqtë e fëmijëve”**

Rendi i ditës:

1. Hapja e mbledhjes dhe fjala e zotit Gramoz Ruçi, Kryetar i Kuvendit, Kryetar i grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”.
2. Prezantimi i raportit “Veprimtaria e grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” për vitin 2018”, nga zonja Vasilika Hysi, zëvendëskryetare e Kuvendit dhe zëvendëskryetare e grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”.
3. Pyetje/përgjigje, diskutime rreth raportit.
4. Miratimi i kalendarit të punës së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” për periudhën mars - korrik 2019.
5. Çështje të tjera

Të ftuar:

Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Besa Shahini – Ministre e Arsimit
Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë
Elisa Spiropali – Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Arda Hoxha - përfaqësuese e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
Ervis Bedo – përfaqësues nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

Eda Beqiri– përfaqësuese e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve
Shoqërore

Merita Xhafa – përfaqësuese nga Ministria e Shëndetësisë

Viola Kola – përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë

Befis Fusha – Fotograf

Roberto de Bernardi – përfaqësues i UNICEF-it në Shqipëri

Emira Shkurti - përfaqësuese e UNICEF-it

Elda Hallkaj – përfaqësuese e UNICEF-it

Iva Zajmi – konsulente e UNICEF-it

Ermal Como – përkthyes i UNICEF

Kaludio Pulaha – përfaqësues i CRCA-së

Anila Meco – përfaqësuese nga Save the Children

Melaim Demnushaj – përfaqësues nga “Të ndryshëm dhe të barabartë”

Linda Pino – koordinatore kombëtare e Koalicionit për Arsimin në Shqipëri,

Eridjona Vallja – përfaqësuese e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe te

Rinjve

Ervjola Osmanaj – përfaqësuese e Rrjetit Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri

(ANYN)

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar deputetë pjesëmarrës në grupin “Miqtë e fëmijëve”,

Në cilësinë e Kryetarit të këtij grupi, fillojmë takimin.

Para se të vijojmë me rendin e ditës, dua të vlerësoj shumë arritjet e veprimtarisë së këtij grupi për vitin që lamë pas, lidhur me rritjen e ndjeshmërisë dhe ndërgjegjësimit, veçanërisht të deputetëve pjesëmarrës të këtij grupi, jo vetëm, por edhe të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë në funksion të krijimit të një klime mbështetëse për çështjet për të cilat ky grup është krijuar, për çështjen e fëmijëve, ndaj institucionit të Kuvendit të Shqipërisë.

Gjithashtu, dua të inkurajoj grupin për veprimtarinë e tij të mëtejshme gjatë këtij viti kalendarik, me qëllimin e mirë për të avancuar angazhimet për trajtimin e çështjeve dhe problematikave të fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe për realizimin dhe plotësimin e planit të veprimit dhe të kalendarit të veprimtarisë së Grupit “Miqtë e fëmijëve”.

Një ndër arritjet më të qenësishme për vitin 2018 ka qenë propozimi i deputetëve, anëtarë të grupit “Miqtë e fëmijëve”, të projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për gjendjen civile. Ky ligj u miratua në seancën plenare në muajin tetor të vitit 2018, duke përfaqësuar dhe mundësuar procedura të qarta për caktimin e shtetësisë, si dhe për të vënë në rrugën e zgjidhjes regjistrimet dhe lëshimin e dokumenteve të njoftimit apo qëndrimit për personat me këtë status, si dhe në lehtësimin e barrierave ligjore dhe ato administrative për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve shqiptarë të lindur jashtë vendit ose edhe atyre të lindur në Shqipëri, të cilët u përkasin kategorive të marginalizuara.

Grupi ynë ka shqyrtuar edhe çështje të tjera, ka bërë edhe rekomandime të dobishme për përmirësimin e gjendjes së fëmijëve shqiptarë, të cilat do të paraqiten në mënyrë më të detajuar në raportin vjetor, me të cilin do të njihemi në këtë takim.

Kështu që pa e zgjatur më shumë, do të vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që është prezantimi i raportit të veprimtarisë së grupit “Miqtë e fëmijëve”, i cili synon të prezantojë veprimtarinë e këtij grupi për vitin 2018, si dhe sfidat, arritjet dhe objektivat afatmesme 2019-2021 të planifikuara për grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve”.

Për prezantimin e këtij raporti, fjalën ia kaloj zonjës Hysi, zëvendëskryetare e Kuvendit të Shqipërisë dhe zëvendëskryetare e grupit “Miqtë e fëmijëve”.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Shumë faleminderit të gjithë anëtarëve të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, jo vetëm, por edhe të gjithë deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, shoqërisë civile dhe medias.

Në fakt, seanca sot është një llogaridhënie që ne bëjmë në emër të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, ku sipas rregullores së grupit, kryetari i grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” duhet të paraqesë në seancë plenare raportin vjetor dhe, për rrjedhojë, para se ky raport të paraqitet në seancë, do të diskutohet midis grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”.

Një risi për vitin 2018 është se numri i deputetëve, që iu bashkua këtij grupi, është rritur, ka shkuar në 32 deputetë nga të gjitha grupet parlamentare. Grupi vazhdon të jetë i fokusuar në çështjet që lidhen me përmirësimin e legjislacionit, që parashikon mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndërmarrjen e nismave ligjore, organizimin e seancave dëgjimore, pyetjeve, interpelancave me përfaqësues të qeverisë dhe organizatat e shoqërisë civile lidhur me mbledhjen e informacionit për situatën e fëmijëve, promovimin e instrumenteve të rinj.

Ajo që dua të theksoj, pa u ndalur në strukturën, përbërjen dhe ndarjen e deputetëve nëpër grupe, sepse të gjithë e keni materialin në dosje, është se veprimtaria kryesore për vitin 2018 ka qenë e fokusuar në disa drejtime:

Së pari, takime me fëmijët dhe sesione informimi me ta. Grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” ka mirëpritur në 4 takime dhe sesione informuese fëmijë dhe të rinj nga i gjithë vendi, ku për një vit kemi pritur 12 mijë fëmijë. Një pjesë e fëmijëve kanë qenë pjesë e sesioneve informuese të bëra nga grupi i deputetëve dhe stafi i Kuvendit lidhur me formularin elektronik dhe përdorimin e informacionit në faqen e Kuvendit me një gjuhë miqësore për fëmijët. Ato kanë qenë sesione informuese, me qëllim njohjen e programit të parlamentit në lidhje me fëmijët, informimin e tyre lidhur me procedurën e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe publikut në veprimtaritë parlamentare dhe mënyrën se si mund ta aksesojnë fëmijët informacionin parlamentar, i cili ka interes për ta.

Së dyti, grupi i deputetëve dhe Kuvendi kanë mirëpritur 400 fëmijë jetimë. Në kuadër të Ditës Kombëtare të Jetimëve në sallën e seancave plenare janë zhvilluar dy aktivitete në datat 19-20 maj. Aty morën pjesë ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrja e Arsimit, ministri i Shtetit për Diasporën, Avokatja e Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Shërbimi Social Shtetëror.

Kryetari i Kuvendit, në cilësinë edhe të kryetarit të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” ka lënë një detyrë për grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, për të adresuar të

gjitha problematikat që ngritën fëmijët jetimë në të dyja sesionet që ne zhvilluam në seancë plenare, por edhe nga shoqatat e fëmijëve jetimë. Kjo do të thotë se për vitin 2019 një nga detyrat, me të cilat ne do të vijmë, është adresimi i të gjitha kërkesave që kanë shtruar fëmijët jetimë, të shoqëruar nga njëri prind, ose familja kujdestare.

Së treti, kemi zhvilluar aktivitete me fëmijë në kuadër të bashkëpunimit me drejtoritë arsimore, kanë qenë ditët e hapura për Kuvendin e Shqipërisë dhe fëmijët kanë vizituar mjediset e Kuvendit dhe janë njohur me Kuvendin, si institucion kushtetues.

Një nga problematikat që ne kemi dhe duam ta ndajmë edhe me ministren e Arsimit është që duhet të ketë më shumë sensibilitet në drejtoritë arsimore jashtë Tiranës për të njohur më mirë Kuvendin, për t'u dhënë më shumë mësuesve, por edhe fëmijëve jashtë Tiranës, për të adresuar shqetësimet, mendimet, sugjerimet e tyre për respektimin e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor, siç ishte rasti i grupit “16 plus” që erdhi nga qyteti i Elbasanit dhe falë mbështetjes së CRCA-së dhe Save the Children ata paraqitën rekomandime konkrete në nivel vendor.

Së katërti, numri i fëmijëve që kanë bërë kërkesë për të ndjekur seancat plenare është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Në këtë kuadër del edhe një detyrë për të gjithë deputetët, në mënyrë të veçantë për deputetët e grupit “Miq të fëmijëve”, për të qenë të vëmendshëm lidhur me përdorimin e gjuhës parlamentare gjatë zhvillimit të seancave plenare, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë te fëmijët.

Aspekti i dytë i veprimtarisë së grupit ka qenë paraqitja e raporteve të hartuara nga vetë fëmijët.

Të nderuar kolegë dhe kolege, kjo është një risi që vetë fëmijët kanë paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë dhe kanë relatuar raporte të hartuara nga ata. Ata kanë monitoruar zbatimin e ligjit për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre. Me datën 1 qershor të vitit 2018, në kuadër të Ditës së Fëmijëve, të organizuar në Kuvendin e Shqipërisë nga Kryetari i Kuvendit së bashku me grupin e fëmijëve “Zëri 16 plus” është paraqitur një raport i detajuar, i cili përmban një sërë rekomandimesh. Fëmijët kanë kërkuar përgjigje për pjesën më të madhe të këtyre rekomandimeve. Besoj se pjesëmarrja e ministres së Arsimit Rinisë dhe Sportit, ministres së Drejtësisë, ministrit të Shtetit për Diasporën, Avokates së Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe përfaqësuesve të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në këtë aktivitet mundëson që ne në vijimësi, në planin që kemi përgatitur për periudhën prill-korrik të vitit 2019, t'u kthejmë përgjigje fëmijëve lidhur me adresimin e kërkesave dhe shqetësimeve të ngritura nga ata.

Gjithashtu, në një takim tjetër të organizuar me një grup fëmijësh nga 5 qytetet të Shqipërisë, anëtarët e grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, por edhe deputetëve të tjerë të Kuvendit, më lejoni t’ju them se grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” nuk përbëhet vetëm nga 32 deputetë, por ka pasur një sensibilitet nga të gjithë deputetët e tjerë, që nuk janë pjesë e grupit, të cilët i kemi të pranishëm në këtë takim dhe kanë marrë pjesë në diskutime dhe në shkëmbim përvojash me fëmijët.

Ka qenë shumë pozitiv bashkëpunimi me Parlamentin Rinor, ata kanë qenë shumë aktivë në diskutimet që kemi bërë në seancë. Ata na kanë adresuar disa kërkesa për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në procesin e konsultimit të projektligjeve që lidhen me fëmijët, dhe jo vetëm, por edhe për të marrë pjesë më aktive në Kuvend, e cila mbetet detyrë për vitin 2019.

Një veprimtari tjetër që ka zhvilluar grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” ka qenë seanca dëgjimore për trajtimin e problematikave të pashtetësisë në Shqipëri. Falë raportit të përgatitur nga Ndihma Ligjore Falas në Shqipëri, nën mbështetjen e Agjencisë së Kombeve të Bashkuara, UNICEF-it, UNHCR-së dhe koalicionit për të drejtën e çdo fëmije për shtetësi, ju e dini se Kuvendi zhvilloi një seancë dëgjimore për këtë çështje dhe ndërmori nismën ligjore, që foli Kryetari, ku ne kemi bërë ndryshimet ligjore në ligjin për gjendjen civile. Ajo që ne kemi marrë si angazhim dhe që e ka lënë edhe detyrë kryetari i grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” është të monitorojmë zgjedhjen e akteve nënligjore dhe zbatimin e tyre, e cila është planifikuar si një veprimtari në proces, që do ta zhvillojmë në bashkëpunim me komisionet e përhershme parlamentare, jo vetëm në Komisionin e Ligjeve, por edhe në Komisionin e Çështjeve Sociale dhe komisionet e tjera. Gjithashtu, në këtë takim kanë marrë pjesë institucionet kushtetuese, por edhe organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare, nga të cilat është kërkuar të adresohen më mirë çështjet që lidhen me regjistrimin e fëmijëve dhe me mundësinë e financimit të faturës financiare, të ADN-së dhe të ekzaminimeve të tjera. Fakti që ne në këtë mbledhje kemi shumë anëtarë të Komisionit të Financave dhe Ekonomisë, por edhe të Komisionit të Jashtëm besoj se do të adresohen edhe shqetësimet që kemi me fëmijët që janë në Greqi, në Itali dhe krijimin e lehtësirave nëpërmjet shërbimeve konsullore.

Një aspekt tjetër i grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” kanë qenë takimet e komiteteve. Grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” është i ndarë në pesë komitete dhe çdo komitet ka një fokus të caktuar. Komitetet kanë bërë mbledhjet e tyre dhe kanë adresuar problematikat në fushat përkatëse.

Në fakt, angazhimi i anëtarëve të grupit “Miqtë e fëmijëve” nuk është vetëm në këtë grup, por është edhe nëpër komisionet e përhershme dhe nënkomisionet parlamentare. Ka

pasur një aktivitet të zgjeruar të Kuvendit të Shqipërisë dhe të komisioneve të përhershme dhe nënkomsioneve për të adresuar çështjet e fëmijëve. Janë zhvilluar 6 seanca për shqyrtim dhe miratim projektligjesh, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me interesat e fëmijëve dhe 12 seanca dëgjimore me ministra, drejtues dhe përfaqësues të ministrive dhe institucioneve në varësi.

Ajo që duhet të bëjmë më mirë dhe mbetet detyrë për vitin 2019 është evidentimi i përvojave që kanë komisionet e përhershme parlamentare dhe nënkomsionet, pasi në këtë raport nuk përfshihet veprimtaria e zhvilluar në nivel komisioni ose nënkomsioni. Në këtë kuadër, raporti përmban vetëm veprimtarinë që ka bërë grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, por që Kuvendi ka bërë më shumë. Pra, duhet të shikojmë mundësinë për të pasur një database, një informacion shumë më të mirë, në mënyrë që t’ua adresojmë ministrive përkatëse.

Një aspekt tjetër i veprimtarisë së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” kanë qenë ndryshimet ligjore të propozuara në ligjin për gjendjen civile, ku ndërkohë ka disa nisma, të cilat janë adresuar në Kuvendin e Shqipërisë, për të cilat do të flasim në çështjen tjetër të rendit të ditës.

Si përfundim dua t’ju them se veprimtaria e zhvilluar nga grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” gjatë vitit 2018 ka ndikuar në rritjen, ndërgjegjësimin dhe ndjeshmërinë e deputetëve, jo vetëm anëtarëve të grupit, por të të gjithë deputetëve.

Së dyti, janë adresuar probleme konkrete që lidhen me të drejtat e fëmijëve edhe një sërë ligjesh të tjera, që kanë kaluar në Kuvend, është rritur niveli i kontrollit parlamentar dhe me këtë rast dua t’ju sjell në vëmendje që shumë shpejt Kryetari i Kuvendit do të mbledhë mekanizmin ndërinstitucional për të parë zbatimin e rekomandimeve të të gjitha institucioneve të pavarura që raportojnë në Kuvend. Ne kemi fatin që kemi ministër Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe bashkërendimi i veprimtarisë midis qeverisë dhe Kuvendit besoj se do të jetë më efektiv dhe do të kemi mundësi të ndjekim zbatimin e rekomandimeve.

Sot Komisioni i Ligjeve ka filluar edhe me raportimin e institucioneve të pavarura. Në raportin e parë ne patëm çështje që lidhen edhe me të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve dhe fëmijëve. Kështu që do të kemi mundësi që këto shqetësime t’i adresojmë më mirë. Bashkëpunimi me shoqërinë civile është konsoliduar dhe unë dua që në emër të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, t’i falënderoj ata. Ata kanë qenë shumë aktivë jo vetëm në ligjin për gjendjen civile, por edhe në ligjin për parandalimin e dhunës në familje, në ligjin për strehimin social, për ndihmën juridike, për taksat dhe tarifat gjyqësore dhe një sërë ligjesh të tjera.

Ajo që dua të kërkoj, edhe në emër të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, është që shoqëria civile duhet të akreditohet. Ne kemi ende organizata të shoqërisë civile që nuk kanë bërë procedurën e akreditimit pranë Kuvendit të Shqipërisë, i cili është një detyrim që buron nga Kodi i Sjelljes dhe Rregullorja e Kuvendit. Për rrjedhojë, ndërlidhësi i shoqërisë civile nuk mund të dijë se kujt mund t’ia adresojë projektligjet, kë mund të ftojë në seanca dëgjimore dhe kë mund të ftojë për të dhënë opinione, pasi nuk kemi akreditimin e organizatave të shoqërisë civile, ku pjesa më e madhe e tyre punon edhe në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Gjithashtu, meqenëse e pranishme është edhe ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, një nga pikat e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për të drejtat e fëmijëve, që kemi objektiv për vitin 2019, është monitorimi i axhendës për të drejtat e fëmijëve. Në dijeninë tonë, ministria dhe komiteti përkatës është duke e riparë axhendën dhe brenda muajit mars do ta miratojmë. Ne, në emër të grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” ne kërkojmë që kjo axhendë t’i paraqitet grupit, në mënyrë që të bëjnë kalendarin e veprimtarive të monitorimit të saj.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, në kuadër të bashkëpunimit parlamentar ndërkombëtar, por edhe detyrimeve që kemi nga Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, nga Këshilli i Europës, nga Bashkimi Europian e të tjerë, Kuvendit të Shqipërisë i është kërkuar të forcojë rolin e kontrollit të zbatimit të konventave.

Shumë shpejt, në mbledhjen e radhës, do të paraqitet raporti shtetëror për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, i cili do të jetë një objekt diskutimi në grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, por unë propozoj që ai të jetë edhe në komisionet përkatëse. Besoj se do të ketë një seancë dëgjimore për raportet IE në muajin prill dhe do të ketë përfaqësues të shoqërisë civile në Gjenevë. Ne nuk e dimë se cilat janë raportet IE të përgatitura, por besoj se do të ketë një raport nga qeveria shqiptare, ku duhet të ishte edhe kontributi i Kuvendit, si një mekanizëm i kontrollit parlamentar.

Së fundi, partnerët dhe bashkëpunëtorët kanë qenë të shumtë dhe unë nuk dua t’i përmend, sepse i kemi të listuar në raportin që kemi përpara. Jeni të lirë që të na informoni nëse dikush nuk e gjen emrin apo kontributin e tij në këtë raport, sepse raporti, para se të paraqitet në seancë plenare, ka mundësi të plotësohet dhe te përmirësohet.

Këto janë në vija të përgjithshme veprimtaritë e grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”. Ndërkohë që në dosjen e secilit prej jush është vendosur projektkalendari i veprimtarive që do të ndjekë grupi “Miqtë e fëmijëve” për periudhën mars-korrik 2019, ku fokusi kryesor do të jetë monitorimi i veprimtarisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe

Çështjeve Sociale lidhur me shëndetin e fëmijëve, jodizimin e kripës, nëse do të ketë nevojë për përmirësime ligjore, adresimin e dhunës seksuale dhe sigurinë në internet, e cila është një çështje që lidhet me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Arsimit, si dhe diskutimi i raportit për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

Ndërkohë, Kryetari i Kuvendit ka autorizuar deputeten Milva Ekonomi, si përfaqësuese, e cila do të ndjekë zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm AXHENDA 2030.

Është kërkuar, në kuadër të kalendarit, që grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” të monitorojë në bashkëpunim edhe me përfaqësuesen, zonjën Ekonomi, zbatimin e objektivave me fokus fëmijët. Këto janë nga disa nga objektivat që ne kemi për vitin 2019.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Hysi!

Kush ka pyetje rreth raportit përpara se ai të bëhet gati për t’u draftuar për seancën plenare?

Po, zonja Ministre.

Ogerta Manastirliu – Faleminderit, zoti Kryetar!

Ky është një ndër aktivitetet që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka qenë pjesë nëpërmjet të gjitha raportimeve periodike dhe të gjitha proceseve vendimmarrëse në raport me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sepse na bashkon interesi më i lartë i fëmijëve. Unë gjej rastin të falënderoj Kryetarin e Kuvendit, zëvendëskryetaren dhe të gjithë ata, të cilët kanë në fokus interesin më të lartë të fëmijëve. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është duke punuar qartë për të përmbushur të gjitha detyrimet e konventave ndërkombëtare të ratifikuara dhe në zbatim të AXHENDËS Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, e cila është një axhendë, plani dhe masat e secilës janë të konceptuara shumë mirë, por sfidat janë shumë të mëdha në raport me të gjitha detyrimet që mbart AXHENDA Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve.

Ne aktualisht jemi duke hartuar raportin e vlerësimit afatmesëm të implementimit të kësaj axhende dhe do të kërkojmë që i gjithë ky raport të ishte pjesë përbërëse e raportit që do të dorëzojë në parlament grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”.

Dua të bëj një raportim sintezë për punën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të Agjencisë së Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me statusin e mbrojtës së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Dua ta nis me atë që është kryesorja, me veprimtarinë legislative dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, i cili është një ligj i miratuar në vitin 2017 dhe është detyrimi yni të plotësojmë të gjitha aktet nënligjore të tij. Ndaj, dua të raportoj se deri më tani ne kemi miratuar nëntë vendime të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji. Vendimi i fundit i Këshillit të Ministrave ishte i ditës së sotme, kur qeveria miratoi procedurat për riatdhësimin dhe kthimin e fëmijës, një akt nënligjor i pritur për të zbatuar një ndër komponentët dhe nenet e përcaktuara në ligjin për të drejtat e fëmijëve. Gjithashtu, dua t'ju thosha se tashmë ka nisur puna për kompletimin e të gjitha akteve nënligjore. Këtu dua të falënderoj të gjitha institucionet ndërkombëtare, UNICEF-in, OSBE-në, *Save the Children* dhe të gjithë ata ekspertë që janë duke na mbështetur për të hartuar aktet nënligjore në interesin më të lartë të fëmijëve, por duke i bërë ato instrumente sa më shumë të adaptueshme brenda kontekstit të Shqipërisë. Nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve ka filluar të jetë, gjithashtu, pjesë e punës së institucioneve.

Për vitin 2018 Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka mbajtur dy mbledhje. Për vitin 2019 u mbledh Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, i cili miratoi një udhëzim të rëndësishëm që ka të bëjë me zgjedhjen e përfaqësuesve të fëmijëve në Këshillin Kombëtar, një instrument shumë i vlefshëm për t'i bërë fëmijët pjesë e vendimmarrjes.

Nga ana tjetër, dua të shtoj se në kuadër të implementimit dhe zbatimit të konventave që kemi ratifikuar dhe kemi shumë detyrime, të cilat kemi për të përmbushur, si dhe të gjitha rekomandimet që derivojnë nga këto konventa. Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së Fëmijëve është një përfaqësuese dinjitoze e Shqipërisë në mbledhjet e punës qoftë të Komitetit të Langaroces për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, gjithashtu, dhe të komitetit *ad hoc* pranë Këshillit të Europës, ku diskutohen pikërisht ato sfida e problematika jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë botën, siç janë abuzimi seksual dhe mbrojtja *online* e fëmijëve. Këto sfida do të targetohen dhe po targetohen me programe dhe ndërhyrje konkrete të planifikuara gjatë vitit 2019.

Gjithashtu, dua të them se një ndër sfidat që kemi të adresuar, që kërkon mbështetje dhe një fokus jo vetëm të punës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por të të gjitha institucioneve, të Ministrisë së Drejtësisë, të Ministrisë së Arsimit, të Ministrisë së Brendshme janë edhe strukturat që ne kemi në terren. Për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe vetë fëmijët ne duhet t'i përqendrojmë forcat tona për të forcuar njësitë e mbrojtjes së fëmijëve. Është një detyrim i të gjithëve për të punuar për trajtimin e ekipeve përbërëse të njësisë të mbrojtjes së fëmijëve, si struktura të cilat bashkërendojnë përpjekjet e përbashkëta

të institucioneve shtetërore, por edhe të organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit lokal, që ka një rol të rëndësishëm në këto njësi, për t'i bërë ato njësi me eficiente dhe për t'i bërë ato vërtet struktura, të cilat referojnë në kohë çdo problematikë të fëmijëve kudo që ata janë, qofshin në shkolla, kopshte apo në komunitet.

Dua të raportoj këtu disa shifra të rëndësishme, të cilat tregojnë sot punën tonë. Aktualisht janë 235 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, të cilët punojnë në të gjithë vendin për të adresuar çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në vitin 2018 njësitë për mbrojtjen e fëmijës kanë menaxhuar 1897 raste të fëmijëve që kanë pasur nevojë për t'u mbrojtur nga dhuna, abuzimi apo shfrytëzimi, nga këto 997 kanë qenë raste të reja, pra kemi të bëjmë këtu me fenomene, të cilat ende kanë nevojë për t'u adresuar në mënyrë multidisiplinare. Pra, qasja multidisiplinare e punës që duhet të kemi tashmë si ekipe dhe jo vetëm si ministri dhe institucione të veçanta është shumë e rëndësishme në trajtimin me efikasitet të çdo problematike që lidhet me fëmijët. Ndaj, edhe plani individual për fëmijët në strukturat e komuniteteve lokale është një element shumë i rëndësishëm, i cili është tashmë në axhendën tonë dhe është përfshirë në të gjitha protokollet e punës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Gjithashtu, Agjencia e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve ka ndjekur në njësitë e mbrojtjes së fëmijëve 78 raste të fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje. Në kuadër të monitorimit të punës së njësive të mbrojtjes së fëmijëve, Agjencia ka filluar edhe monitorimet në terren dhe po punon për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe profesionistëve në nivel vendor qoftë për njohjen e ligjit dhe akteve nënligjore, të cilat janë në përmbushje të detyrimeve tona, por edhe për të ofruar një mbrojtje efektive për fëmijët në rrezik dhune, abuzimi e shfrytëzimi.

Gjithashtu, do të doja të ngrija disa shqetësime që lidhen me përgjegjësitë e reja që ne kemi dhe adresimin e këtyre çështjeve. Edhe Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur kërkon, gjithashtu, që njësitë e mbrojtjes së fëmijëve të marrin këto përgjegjësi të reja lidhur me njohjen dhe me trajtimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin. Ndaj Ministria e Shëndetësisë me Ministrinë e Drejtësisë janë duke bashkëpunuar qoftë për nxjerrjen e akteve nënligjore të përbashkëta, por edhe për procedurat dhe protokollet, në mënyrë që trajtimi i fëmijëve në konflikt me ligjin të jetë sipas të gjitha dispozitave të miratuara. Gjithashtu, edhe njohja e punonjësve që punojnë me këtë fëmijëve. Duhet mundësohet një njohje më e thellë e legjislacionit, e akteve nënligjore dhe zbatimi me efikasitet i tyre, qoftë i ligjit për drejtat e fëmijëve, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, qoftë ligji për shërbimet shoqërore.

Do të doja, gjithashtu, të adresoj këtu edhe disa çështje e sfida të mëtejshme lidhur me aksesin në shërbim. Aksesin në shërbimin shëndetësor dhe aksesin në shërbimet e sociale

janë sfida, për të cilat ne jemi duke punuar çdo ditë për t'i përmirësuar. Pa dyshim që kemi arritje, të cilat vijnë nga politikat e reja që qeveria ka ndërmarrë në raport me mbështetjen e fëmijëve. Patjetër që vëmendja jonë është tek ai grup fëmijësh që është i marginalizuar, si fëmijët e dhunuar, të trafikuar, fëmijët që janë subjekt i abuzimeve seksuale. Gjithashtu, duhet të vlerësojmë edhe politikat e reja të qeverisë lidhur me mbështetjen e fëmijëve për t'i vendosur ata në një stad të njëjtë. Bonusi i bebe është bërë efektiv nga muaji janar 2019 dhe është një politikë e re e mbështetjes sociale, e mbështetjes për familjen, mbi të gjitha, për vendosjen në një stad të njëjtë të të gjithë fëmijëve do të mbështesë familjet, nënat dhe fëmijët. Do të jenë rreth 30 mijë fëmijë në vit, të cilët do të mbështeten direkt nga bonusi i bebes. Gjithashtu, aksesit në shërbimet shëndetësore nëpërmjet programit tonë të vaksinimit për mbulesën vaksinale, përmirësimin e qendrave shëndetësore, të kujdesit të nënës dhe fëmijës brenda strukturave tona të shëndetësisë. Aksesit më i mirë për shërbimin shëndetësor influencon direkt në përmirësimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Dua të përmend këtu edhe programin tonë të shërbimeve sociale, i cili ka në fokus të punës së tij ngritjen e shërbimeve sociale në territor. Ne sot kemi qendrat tona rezidenciale, të cilat ofrojnë kujdes për fëmijët pa kujdes prindëror. Plani ynë kombëtar "Fëmijët të parët" është vendosur tashmë në prioritetet e punës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në raport me deinstitutionalizimin për sa u përket fëmijëve, të cilët janë në qendrat tona të kujdesit, për t'u kthyer te familjet biologjike, për të mundësuar kujdesin alternativ dhe për të shkuar drejt procedurave më të shpejta për proceset e birësimit. Pra, interesi i fëmijëve është në plan të parë të të gjitha politikave tona. Gjithashtu, instrumentet që po ndërton Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të mbështetura nga qeveria, për sa i përket fondit social do të garantojnë që shërbimet sociale në territor të jenë më të aksesueshme, më efektive dhe më gjithëpërfshirëse në raport me fëmijët, të cilët janë të riskuar nga abuzimi, nga shfrytëzimi, nga dhuna dhe kërkojnë një qasje të menjëhershme e konkrete në territor nëpërmjet shërbimeve sociale.

Dua të përmend se ne po hartojmë edhe draftin e planit kombëtar të veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, duke përfshirë edhe fëmijët në situatë rruge. Për vitin 2018 janë 349 raste të identifikuara në situatë rruge, ku 286 raste janë në proces menaxhimi pikërisht nga strukturat lokale, nga strukturat rezidenciale të qendrave të mbështetura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjithashtu edhe nga njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në ndjekjen në komunitet.

Unë bëra një raport sintezë të punës së bërë, të asaj që ne kemi realizuar, prioritetet dhe sfidat që adresojnë çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe Ministria e

Shëndetësisë shpreh edhe një herë gjithë angazhimin e të gjitha strukturave të saj për të adresuar në mënyrë të menjëhershme për të marrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Po, zonja Ministre e Arsimit.

Besa Shahini – Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë, fëmijët kanë të drejtë të shkollohen në mënyrë cilësore dhe të arrijnë potencialin e tyre maksimal brenda sistemit shkollor.

Dua shumë shkurtimisht të përmend disa nisma dhe disa indikatorë që tregojnë punën që është bërë vitet e fundit që kjo të realizohet. Nga 9-vjeçarja, që është shkollimi i detyrueshëm në Shqipëri, kalohet në shkollën e mesme. Më parë ka pasur një numër të madh të nxënësve, të cilët nuk e kanë bërë këtë kapërcim. Në vitin 2012 rreth 4500 nxënës, që kanë mbaruar në atë kohë 8-vjeçaren, nuk kanë kaluar në shkollën e mesme. Sot kemi ende punë për të bërë, por ky numër është diku rreth 1000, pra kemi 1000 nxënës, të cilët kur e mbyllin arsimin e detyruar, jo domosdoshmërisht kalojnë në arsimin e mesëm. Nga gjurmushmëria ne mundohemi të gjejmë se cilat janë arsyt që ndodh kjo. Një pjesë janë edhe në emigracion, por në përgjithësi, duke marrë parasysh nismat që janë ndërmarrë gjatë viteve të fundit, është ngritur edhe vetëdija e familjeve dhe pjesa më e madhe e nxënësve kalojnë nga shkolla 9-vjeçare në atë të mesme, që është një rezultat pozitiv i punës që është bërë gjatë viteve të fundit.

Kemi edhe një indikator interesant që ne jep testi “PISA”, ku është marrë aftësia bazike e lexueshmërisë, e matematikë-shkencës për të gjithë nxënësit 15-vjeçarë, pra klasa e 9-të apo e 10-të. Kjo bëhet në mënyrë periodike çdo tre vjet. Krahasuar me vitin 2012, rezultatet e vitit 2015 tregojnë dy gjëra pozitive për Shqipërinë: e para, Shqipëria nga të gjitha vendet që kanë marrë pjesë në këtë testim të aftësive bazike të nxënësve ka bërë progresin më të shpejtë nga vitit 2012-2015; e dyta, vajzat janë diku 2,5 vjet para djemve për sa u përket diturive dhe njohurive në shkollë. Edhe ky është rezultat i punës së mirë që është bërë, ku fokusi është kaluar te vajzat, të cilat tradicionalisht nuk e kanë pasur ndoshta vëmendjen e duhur. Tani duhet ta balancojmë këtë dhe ta kthejmë fokusin mbrapsht te djemtë që të kapin hapin e vajzave, të cilat kanë ecur shumë përpara.

Për sa i përket fenomenit të klasave kolektive, ai është një fenomen që nuk ekziston vetëm në Shqipëri, por kudo ku kemi komunitete që jetojnë në zona rurale, pra zvogëlohet numri i nxënësve, ndaj nuk mund të ketë mësues për aq pak nxënës dhe vendosen nxënës të

grupmoshave të ndryshme të mësojnë brenda së njëjtës klasë. Kjo gjë e vështirëson jashtëzakonisht shumë punën e mësuesit, rrjedhimisht edhe cilësia e mësimdhënies nuk është aty ku duhet. Vitin e kaluar kemi arritur ta racionalizojmë, siç i quajmë ne, diku rreth 250 klasa kolektive që ndikon rreth 3000 nxënës, të cilët sot mësojnë në klasa me bashkëmoshatarët e tyre në shkollat më të afërta. Kemi reduktuar numrin e nxënësve që mësojnë në klasa kolektive nga 33 mijë në rreth 27 mijë, ngaqë ka pasur edhe rënie të numrit të nxënësve në shkollat 9-vjeçare. Ngaqë pilotimi që bëmë vjet rezultoi i suksesshëm, do të racionalizojmë edhe klasat e tjera kolektive, ku kemi mundësi të sigurojmë transport dhe ku infrastruktura e lejon këtë gjë. Rrjedhimisht, kjo gjë rrit edhe cilësinë e mësimdhënies për këta nxënës. Kemi bërë një test sivjet dhe do t'i marrim rezultatet shumë shpejt për të parë tamam se sa ka ndikuar ky kalim i nxënësve nëpër klasa më bashkëmoshatarët e tyre te njohuritë e tyre bazë, si lexueshmëria, matematika dhe shkencat.

Për sa u përket librave falas, vjet kemi arritur të furnizojmë të gjithë nxënësit e klasave nga e para deri tek e katra me libra falas, si dhe të gjithë nxënësit e tjerë që u përkasin kategorive të ndryshme në nevojë, si fëmijët me nevoja të veçanta, me asistencë sociale etj. Sivjet do të furnizojmë edhe klasën e pestë me libra falas me idenë që deri në vitin 2021 do ta mbulojmë të gjithë arsimin e detyrueshëm me libra falas. Kjo është një ndihmë jo vetëm për buxhetin familjar, por lehtëson edhe gjithë procesin e mësimdhënies në klasë dhe mësuesit nuk kanë nevojë të mendojnë nëse nxënësi ka pasur apo jo mundësi ta sigurojë librin në kohë etj.

Për sa u përket mësuesve ndihmës, kemi nxënës me nevoja të veçanta në shkollat tona dhe ata kanë nevojë për një ndihmë shtesë, që të arrijnë potencialin e tyre maksimal brenda sistemit arsimor. Në vitin 2013 nuk ka pasur fare mësues ndihmës në sistem, sot janë 900. Kemi shumë punë për të bërë që ata të trajnohen tamam, që ta bëjnë tamam mësuesin ndihmës dhe t'i ndihmojnë nxënësit të tejkalojnë sfidat e ndryshme brenda sistemit shkollor. Kështu shohim se ku i kemi vendosur mësuesit ndihmës, pra pranë nxënësve me nevoja të veçanta, duke bërë një hap të mirë në këtë drejtim.

E fundit që do të përmend është përdorimi i sigurt i internetit. Këtu kemi një sfidë të madhe. Për shkak se duhet ngërthehet përdorimi i sigurt i internetit me edukimin seksual, kemi futur në shkolla kurrikulat për edukimin social dhe për edukimin e sigurt. Kjo pastaj duhet të kombinohet shumë më mirë që fëmijët të mbrohen nga rreziqet që paraqet përdorimi i internetit. Sfida është se industria është një hap para politikebërësve, kështu që zhvillimi i madh i teknologjisë informative na ka lënë pak mbrapa në adresimin e rreziqeve të mundshme që nuk kemi arritur t'i parashtrijmë me kohë, por jemi duke bërë hapa të

mëdhenj para. Unë shpresoj që edhe me ndihmën e organizatave të ndryshme të Kombeve të Bashkuara do të arrijmë të realizojmë edhe këtë synim që e kemi marrë përsipër. Ambiciet tona janë shumë më të mëdha se ato që kanë qenë para disa vjetve. Sa më shumë të bëjmë, aq më shumë presim të bëjmë. Kështu që kemi sfida të mëdha përpara. Unë vërtet shpresoj që me këto politika që kemi nisur dhe me të rehat që do të fillojmë sivjet, do të arrijmë të ndihmojmë secilin nxënës, secilin fëmijë që të arrijë potencialin e tij maksimal brenda sistemit arsimor në Republikën e Shqipërisë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Po, zonja Ministre.

Etilda Gjonaj – Shkurtimisht dua t’ju njoh me disa nga zhvillimet që Ministria e Drejtësisë ka bërë në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Ministrinë e Drejtësisë për herë të parë e sheh drejtësinë penale për të mitur si një objektiv prioritar, pasi drejtësia sociale tashmë është futur te prioritetet kryesore që qeveria shqiptare po ndërmerr nëpërmjet masave të ndryshme jo vetëm për të mundësuar rehabilitimin e të miturve në kontakt me organet e drejtësisë, por ajo që është shumë e rëndësishme dhe që nuk i është kushtuar vëmendja e duhur për një periudhë shumë të gjatë është pikërisht parandalimi i veprave penale apo i përfshirjes së të miturve dhe të rinjve në kriminalitet. Në shtator të vitit 2018 Ministria e Drejtësisë, e mbështetur nga UNICEF, ka përfunduar përgatitjen e strategjisë së të miturve, e cila, gjithashtu, u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave në shtator të vitit 2018 dhe për herë të parë kemi një strategji 4-vjeçare, e cila përmban masa konkrete, objektiva konkrete, me një kostim real për të gjithë indikatorët që duhet të arrihen në kuadër të kësaj strategjie.

Objektivat kryesorë të kësaj strategjie, tashmë të miratuar, janë: garantimi i ekselit së të miturve në organet e drejtësisë, garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit, parandalimi i përfshirjes në krim të të miturve apo edhe të rinjve, rishoqërimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt apo në konflikt me ligjin, si dhe forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë penale për të miturit.

Pjesë e kësaj strategjie janë 17 institucione ligjzbatuese, të cilat, me afate të përcaktuara në këtë strategji, duhet të marrin masa dhe të arrijnë pikërisht treguesit e vendosur. Kjo strategji monitorohet nga një mekanizëm i ngritur tashmë në Ministrinë e Drejtësisë, që bën njëkohësisht edhe koordinimin, edhe monitorimin e zbatimit të saj. Për zbatimin e strategjisë dhe të të gjitha masave që Ministria e Drejtësisë do të ndërmarrë në kuadër të parandalimit të të miturve në përfshirjen në kriminalitet apo riintegrimin të të

miturve, që janë sot në kontakt me organet e drejtësisë, Ministria e Drejtësisë do të sjellë çdo tre muaj një raport pranë grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, me qëllim që të përditësojmë çdo informacion që ka të bëjë me arritjet e kësaj strategjie.

Për herë të parë promovimi, mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve, në veçanti ato në kontakt me organet e drejtësisë, do të jenë vizioni dhe kryefjala e qeverisë shqiptare, si një ndër prioritetet kryesore.

Disa nga arritjet e muajve të fundit, përveç strategjisë, janë: ngritja e rrjetit të përfaqësuesve në nivel qendror dhe organizatave që kanë në fokus të drejtat e të miturve, kryesisht të të miturive në kontakt me organet e drejtësisë, ka përfunduar hartimi i kurrikulave dhe zhvillimi i trajnimeve për 543 profesionistë për t’u specializuar pikërisht për trajtimin e të miturve. Lidhur me seksionet e të miturve që hetojnë dhe gjykojnë të miturit në gjykatë dhe në prokurori, do të ribëhet një riorganizim sapo harta gjyqësore të përfundojë, duke bashkëpunuar me dy këshillat e rinj, me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe me Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Gjithashtu, një fokus i posaçëm i është dhënë kriminalitetit të të miturve nëpërmjet rekomandimeve që Këshilli i Ministrave i paraqet Prokurorit të Përgjithshëm, me qëllim që të zbatohet me efikasitet Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit. Tashmë ka filluar trajnimi i të miturve pranë ambienteve sociale multidisiplinare. Për herë të parë, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, janë ngritur 4 qendra, ku trajtohen të miturit pranë këtyre ambienteve sociale me të gjithë pjesën e trajtimit të kurrikulave, me qëllim që të ketë një trajnim multidisiplinar. Deri tani janë nënshkruar 9 marrëveshje me bashki të ndryshme dhe deri në muajin qershor janë planifikuar të nënshkruhen edhe 22 marrëveshje të tjera me bashkitë më të mëdha, të cilat kanë problematika të kriminalitetit të të miturve. Ambientet e para miqësore janë ngritur në komisariatet e Kamzës dhe janë në proces të ngritjes edhe në disa komisariate të tjera siç është Tirana, Durrësi, Lezha dhe Kurbini.

Në këtë moment të gjithë të miturit, të cilët janë të paraburgosur, me një masë sigurimi nga gjykata, apo janë të dënuar, me një vendim gjykate, të gjithë janë të lokalizuar dhe të vendosur në Institutin e veçantë të Kavajës. Kjo përbën një risi ndryshe nga e gjithë periudha e mëparshme, nga e gjithë ajo që kemi trashëguar, pasi të miturit e paraburgosur kanë qenë të shpërndarë në institucione të ndryshme të ekzekutimit të vendimeve penale, ndërsa sot, për shkak të kushteve që ofron Instituti i posaçëm i Kavajës për të Miturit, në këtë institucion ndodhen 26 fëmijë, ku vetëm dy prej tyre janë të dënuar dhe 24 të tjerët janë të paraburgosur dhe marrin një trajtim shumë më të specializuar se ai trajtim që merrnin përpara në institucione të ndryshme të ekzekutimit të vendimeve penale.

Aktualisht, në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit janë dhënë nga organet kompetente vendimet për aplikimin e alternativave të shmangies nga ndjekja penale 73 masa, ku 60 janë dhënë nga Prokuroria e Tiranës dhe 13 janë dhënë nga Prokuroria e Durrësit. Pra, shikojmë se ka një fillim të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, por kryesisht e fokusuar në ato prokurori, të cilat e kanë më shumë të evidentuar kriminalitetin e të miturve, për shkak edhe të ngarkesës së lartë të numrit të çështjeve që shqyrtojnë automatikisht numri më i lartë i këtyre masave jepen nga këto prokurori. Ndërkohë, sot në shërbimin e provës trajtohen me shërbimet alternative të shërbimit të provës 248 të mitur, ku 238 prej tyre janë djem dhe 10 janë vajza.

Dy objektivat kryesorë për vitin 2019, përveç masave që përmban strategjia, janë: ngritja e qendrës së parandalimit të krimeve të të rinjve dhe të të miturve me programet parandaluese, që do t'i mbikëqyrë pikërisht për një periudhë 6- mujore, pas përfundimit të dënimit të dhënë nga gjykata, këta të mitur.

Së dyti, ngritja e institutit multidisiplinar, i cili do të shërbejë për të trajtuar të miturit që do të vendosen atje me vendim gjykate kur kanë një dënim të dhënë nga gjykata më pak se sa 7 vjet. Për herë të parë kjo është risi jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Ballkanin Perëndimor, duke e konsideruar si modelin më të mirë të zgjedhur nga Shqipëria për sa i përket trajtimit të të miturve.

Paralelisht kemi në proces edhe ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të dhënave për drejtësinë penale për të miturit, sistem i cili në asnjë moment nuk ka ekzistuar dhe nuk ka funksionuar, por kanë qenë me atë problematikë, ku të dhënat për të mitur janë mbajtur në mënyrë manuale. Por për çdolloj risie Ministria e Drejtësisë do të informojë në mënyrë periodike Kuvendin dhe grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve”.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino (*Dëgjohet shumë keq*) – Faleminderit!

Jam i lumtur që jam pjesë e këtij grupi.

Unë i dëgjova me vëmendje zotin Kryetar, zonjën nënkryetare dhe zonjën ministre, prandaj do të bëj disa pyetje, që kanë të bëjnë me aktivitetin që grupi “Miqtë e fëmijëve” ka bërë që kur është krijuar. (*Zoti Fino nuk dëgjohet.*)

Unë dua të di: që nga ajo kohë dhe deri më sot çfarë problematikash janë adresuar dhe janë zgjidhur?

(*Zoti Fino nuk dëgjohet.*)

Unë nuk e shoh në raport dhe dua të evidentohet në të ardhmen: si ka qenë dhe si është menduar lidhja e këtij grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” me organet e pushtetit vendor? Shumë problematika nuk mund t’i zgjidhin vetëm ministrinë. Pa ndihmën e pushtetit vendor dhe të kryetarëve të bashkive, të këshillave bashkiakë përkatës unë e shikoj të pamundur. Prandaj dua të di: si është menduar? Zoti Kryetar, mbase duhet të bërë një takim tjetër me institucionet përkatëse që merren me këtë gjë dhe me drejtuesit e pushtetit vendor, që ta shtrijmë në të gjithë Shqipërinë, për të pasur një kohezion të plotë për këtë çështjeje.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

A ka mendime të tjera?

Urdhëroni!

Linda Pino – Përshëndetje të gjithëve!

I nderuar zoti Ruçi,

E nderuar zonja Hysi,

Ju falënderoj për ftesën!

Unë jam Linda Pino dhe përfaqësoj Koalicionin për Arsimin në Shqipëri, i cili është një rrjet i organizatave të shoqërisë civile. Edhe ne kemi qenë shpeshherë në dyert e Kuvendit, në seanca të ndryshme dëgjimore, për të avancuar të drejtën e fëmijëve për arsim, por edhe për të bërë të mundur rritjen e buxhetit për arsimin parauniversitar publik në Shqipëri.

Duke qenë në seanca të ndryshme dëgjimore, por duke ndjekur edhe nga afër çështjen e dhunës ndaj fëmijëve, në këtë dëgjuesë të grupit “Miqtë e fëmijëve”, dua të ngre çështjen dhunë dhe bulizmin në institucionet arsimore. Nuk janë të pakta rastet e dhunës që media bën publike, por nuk janë të pakta edhe shifrat që nxjerrin studime të ndryshme. Në vitin 2016 Ministria e Arsimit ka bërë një studim në kuadër të projektit “Kondi”, ku raporton se një në tre fëmijë ka përjetuar dhunë psikologjike në shkolla dhe një në tetë fëmijë ka përjetuar dhunën apo kërcënimet nga mësuesit.

Nëse më lejoni, unë dua të bëj një sugjerim për sa i përket punës suaj si grup i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, që në seksionin “Fëmijët, dhuna seksuale dhe siguria në internet”, të ngrihet një plan kombëtar për dhunën ndaj fëmijëve, ku të përfshijë jo vetëm “Dhunën seksuale, siguria në internet”, por të gjithë dhunën psikologjike dhe fizike që ushtrohet ndaj fëmijëve, duke përfshirë këtu edhe strategji të ndryshme që janë hartuar në nivel kombëtar.

Gjithashtu, duke qenë se ministrja e Arsimit është e pranishme në këtë takim, gjatë muajt shkurt, por edhe dje janë bërë dy tryeza konsultimi për sa i përket sistemit të shërbimit psikosocial në institucionet arsimore parauniversitare. Si koalicion kemi bërë një raport, i cili është konsultuar gjerësisht për sa i përket efikasitetit të modelit aktual që ka sistemi arsimor parauniversitar në mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe bulizmi në shkolla.

Në tryezën e organizuar në Kryeministri psikologët nxorën problemet e tyre dhe arritën në konkluzionin se ky sistem aktual ka nevojë të riformohet. Duke qenë se ne kemi një ligj të ri “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” është një nen, i cili e detyron Ministrinë e Arsimit të ngrejë mekanizmat efikasë për të bërë të mundur mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna kur ata janë në institucionet arsimore.

Progresraporti i vitit 2018 për Shqipërinë ka rekomanduar që vitin e ardhshëm Shqipëria duhet të përmirësojë mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe të garantojë barazinë gjinore.

Gjithashtu, kemi edhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Nuk mund të arrijmë të kemi një arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë nëse do të kemi në shkolla fëmijë të dhunuar psikologjikisht, fizikisht apo nga fenomeni i bulizmit. Kështu që, ftoj Ministrinë e Arsimit, në kuadër të të gjithë rekomandimeve që janë bërë nga institucione apo progresraporte, të bëjë të mundur ngritjen e një grupi për rishikimin e dispozitave normative për t’i përshtatur ato edhe me ligjin e ri “Për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve”.

Jemi në një moment ku edhe strategjia e arsimit parauniversitar në katër shtyllat e saj politike që ka, nuk ka aspektin e mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna në institucionet arsimore. Është një ftesë e hapur, ne si koalicion e kemi ngritur dhe do të vazhdojmë ta ngremë si çështje, por shpresojmë të kemi mbështetjen tuaj si grup parlamentar “Miqte e fëmijëve”, por edhe të Ministrisë së Arsimit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Urdhëroni!

Kaludio Pulaha – Përhëndetje të gjithëve!

Së pari, urime dhe përgëzime për këtë takim!

Jam Kaludio Pulaha nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, CRCA.

E dëgjova me vëmendje të gjithë diskutimin që u bë për sa u përket problematikave të ndryshme, gjithashtu dëgjova edhe ministren Gjonaj për veprat penale të fëmijëve dhe të

rinjve. Në qoftë se i referohemi raportit të fundit që ka bërë CRCA-ja në Shqipëri, rezulton se 50% e veprave penale të kryera në Shqipëri kryhen nga mosha 15-30 vjeç.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të rinjtë dhe adoleshentët e pyetur në të gjithë Shqipërinë shprehen se mungojnë shërbimet, programet cilësore mbështetëse për të rinjtë, të cilët kanë probleme dhe shfaqin sjellje të rënda. Ky shqetësim është ngritur me kohë nga të rinjtë, të fëmijët dhe adoleshentët në të gjithë Shqipërinë.

Në lidhje me arsimimin, jemi duke takuar studentë nga e gjithë Shqipëria dhe na ka rezultuar se në disa qytete të Shqipërisë nuk është rregulluar ende pjesa e teksteve shkollore. Në qoftë se i referohemi arsimit të mesëm, kemi qytete, ku familje në nevojë i blejnë paraprakisht librat dhe më pas rimburohen pas një periudhe 2 ose 3-mujore.

Meqenëse kemi prezent ministren e Arsimit, ne kërkojmë që të merret në konsideratë shqetësimi i ngritur nga fëmijët dhe adoleshentët në disa qytete të Shqipërisë.

Në qoftë se do t'i referohemi arsimimit, në shumë prej qyteteve të Shqipërisë, nga diskutime të ndryshme që kemi bërë me fëmijë dhe adoleshentë, infrastruktura në shkolla ka rezultuar një problematikë më vete. Një problematikë që po ngrihet në të gjitha qytetet e Shqipërisë është siguria jashtë ambienteve të shkollës për fëmijët dhe adoleshentët. Edhe këtu duhen marrë masa, sepse po kthehet një shqetësim shumë i madh për sa u përket fëmijëve dhe adoleshentëve.

Një çështje tjetër që do të donim ta adresojmë, duke iu referuar edhe raportit, është ngritja e një mekanizmi kombëtar për raportimin e dhunës ndaj fëmijëve në shkolla, gjë që e kemi referuar dhe e kemi adresuar edhe më parë dhe shpresoj të merret parasysh si kërkesë.

Së fundi, duke iu drejtuar grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, do të donim që në takimin e ardhshëm të dëgjohej edhe raporti kombëtar “Fëmijët për fëmijët”, i cili është hartuar nga Parlamenti Rinor i Tiranës në bashkëpunim me grupet “16 plus” në disa qytete të Shqipërisë. Këtë kërkesë e kemi dërguar dhe shpresojmë që në takimin e ardhshëm të mund të dëgjojmë edhe gjetjet, por në të njëjtën kohë edhe rekomandimet dhe masat avokuese që vetë fëmijët duan të ndërmarrin në bashkëpunim me ju.

Për sa u përket fëmijëve dhe të rinjve, do t'i sugjerojmë grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” të merrte në konsideratë Parlamentin Rinor në Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë si struktura e vetme, për momentin, vendimmarrëse dhe avokuese në nivel kombëtar për fëmijët dhe adoleshentët dhe të mund të konsiderohen nga grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” si një strukturë konsultative për çdo çështje që prek fëmijët, të rinjtë dhe adoleshentët në Shqipëri.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Urdhëroni!

Anila Meco – Faleminderit!

Jam Anila Meço, drejtoreshë e *Save the Children*. Duke qenë se kam ndjekur punën e këtij grupi prej shumë kohësh, dua të shpreh kënaqësinë që në vitin 2018 ky grup i ka lënë një vend të rëndësishëm pjesëmarrjes së fëmijëve, kontaktit direkt me fëmijët dhe dëgjësës direkte nga goja e tyre për problemet që ata kanë.

Gjithashtu, duke qenë se ju po paraqisni planin për këtë vit dhe duke marrë shkas nga fakti se Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies është në proces të finalizimit të standardeve të pjesëmarrjes së fëmijëve, që jo vetëm rregullon dhe garanton pjesëmarrjen e fëmijëve pranë vendimmarrësve, por mundëson matjen dhe monitorimin se sa ka ndikuar pjesëmarrja e fëmijëve në vendimet e vendimmarrësve. Ndoshta është diçka që ju mund ta shikoni në punën tuaj, sepse, ashtu siç doli nga pyetja e një deputeti, ka shumë gjëra dhe unë e di nga ndërveprimi që kemi pasur me *Save the Children* që ka akte, të cilat janë ndërmarrë si rezultat i zërit të fëmijëve, por do të ishte mirë që këto të mateshin dhe të dokumentoheshin.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zoti Manja!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, kam një pyetje, por paraprakisht, dua të falënderoj Kuvendin dhe kolegët për organizmin e këtij takimi! Ndoshta ky takim, në vazhden e shumë takimeve që ka zhvilluar grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, në vlerësimin tim është aktiviteti më domethënës që zhvillon Kuvendi i Shqipërisë.

Kam një pyetje, duke shfrytëzuar edhe prezencën e ministres së Arsimit, por mora nxitje edhe nga diskutimi i njërit prej përfaqësuesve të shoqërisë civile, dua të di: sa është numri i psikologëve në raport me numrin e fëmijëve që kemi sot në arsimin e parauniversitar? A kemi shkolla që nuk ofrohet ky shërbim sot? E bëj këtë pyetje për një arsye të thjeshtë, duke qenë se sot jemi në diskutimin dhe në miratimin e raportit, që të kemi edhe një rekomandim për ekzekutivin në objektivat afatmesme 2019-2021 në lidhje me këtë shërbim të domosdoshëm për shkollat e arsimit parauniversitar.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Urdhëroni!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Kam dy sugjerime: një e kam për grupin tonë, dhe dua ta vë në vëmendjen tuaj, si Kryetar i Kuvendit, por njëkohësisht jeni ju që kryesoni grupin “Miqtë e fëmijëve”. Unë besoj se stafi i Kuvendit që asiston këtë grup duhet të jetë më aktiv në punën e tij. Shumë mirë që shoqëria civile është prezente, pasi edhe ne na ndihmon të marrim një pamje sa më objektive të situatës së fëmijëve në Shqipëri, pra të mos marrim vetëm një pamje që na e sjellin institucionet qendrore. Ne kemi mundësinë që për disa problematika të mos informohemi thjesht dhe vetëm nga mbledhje të tilla apo nga fakti që shoqëria civile e ka si detyrë ta ngrejë zërin dhe të sensibilizojë opinionin dhe Kuvendin e Shqipërisë, por stafi i Kuvendit ka mundësinë të studiojë të gjithë legjislacionin që lidhet në mënyrë direkte ose indirekte me të drejtat e fëmijëve, të shohë edhe nëse ka detyrime ende të pazbatuara nga Këshilli i Ministrave.

Ministrja e Drejtësisë referoi që, si pasojë e detyrimit që ngre Kodi i Drejtësisë për të Miturit, në Shqipëri duhet të ishte ngritur sistemi që integron të dhënat për fëmijët që janë viktimë e akteve të ndryshme, kryesisht penale, dhe atyre që janë në konflikt me ligjin. Kjo do të na ndihmonte edhe ne për të kuptuar më mirë se si duhet t’i ndërmarim politikat tona. Sipas Kodit, ky sistem duhet të ishte ngritur që në janar të vitit 2018, ndërkohë që jemi me vonesë, pasi sot mund të kishim mundësi të kuptonim se çfarë ofron sistemi, kush ka akses në sistem dhe çfarë vlere do të ketë.

Sugjerimi tjetër ka të bëjë me fushën që ndjek posaçërisht Ministria e Arsimit, kuptohet sepse interesi më i madh është në drejtim të arsimit të fëmijëve. Unë do të doja, në fakt, që çështja e rishikimit të teksteve të bëhet një herë dhe të lihet aty.

Shumë mirë që kur ne erdhëm në pushtet, u bë rishikimi i teksteve. Janë disa qindra tekste që kanë pasur gabime të rënda logjike dhe shumë mirë që ato u hoqën nga qarkullimi, por në media është bërë problem se ka ende tekste të arsimit 9-vjeçar apo edhe atij të mesëm, që përmbajnë probleme të tilla të rënda.

Prandaj mendoj se procesi i rishikimit të teksteve duhet të jetë në mënyrë konstante, nuk e di, mund të vendoset një periudhë kohore, por, gjithsesi, them se duhet të jetë i vijuar.

E dyta, ne vendosëm që të ndryshonim sistemin arsimor 9-vjeçar dhe të kemi sistemin e një lënde në dy orë. Unë nuk jam anëtare e Komisionit të Arsimit dhe *background*-i im nuk lidhet posaçërisht me arsimin, por këtë e gjykoj si anëtare e këtij grupi, edhe si prind. Mendoj se ka ardhur koha që ne të shohim nëse ky sistem ka qenë efektiv në shkollat tona. A është i përshtatshëm edhe për fëmijët, edhe për mësuesit? A ka sjellë një vlerë të shtuar në arsim? Sepse ne morëm një përvojë të huaj, por nuk e dimë se si kjo përvojë funksionon në sistemin tonë.

Gjithashtu, mendoj se ka ardhur koha që ne të përqendrohemi dhe të gjejmë instrumentet e duhura për të reaguar kundër bulizmit, i cili është bërë realisht një fenomen shqetësues në të gjitha shkollat. Pra, duhet të gjejmë një instrument sa më efektiv, duke shmangur burokracitë dhe duke siguruar që fëmijët të marrin ndihmën me psikologë ose ndihmën tjetër të përshtatshme në kohën e duhur, në momentin e duhur.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Përshëndetje!

Zoti Kryetar, unë kam vetëm një shqetësim të vogël. Legjislaturën e kaluar fëmijët përfshiheshin edhe në Nënkomisionin për Barazinë Gjinore. Aktualisht, në fakt, ky nënkomision mbulon vetëm çështjet e barazisë gjinore. Na ka lindur ky problem dhe mendoj se ne duhet të bëjmë një rishpërndarje, ku do të jenë të fokusuar fëmijët: te Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, që drejtohet nga zonja Vasilika Hysi, apo te Nënkomisioni për Barazinë Gjinore, apo do të ketë një nënkomision tjetër, që do të merret vetëm me çështjet e fëmijëve? E kemi pasur si shqetësim dhe donim ta ndanim me ju, sepse realisht ndoshta duhen bërë më tepër, pasi ne, si grupi “Miqtë e fëmijëve” kemi të drejtë të bëjmë rekomandime, por deri këtu mbetet fuqia jonë, apo jo, si grupi “Miqtë e fëmijëve”, ndërsa komisioni ose nënkomisioni përgjegjës ka të drejtë t’i shqyrtojë më hollësisht edhe nismat e reja.

Gramoz Ruçi – Më lejoni edhe mua të them dy-tri mendime.

Ndoshta edhe njoftimet për këtë takim nuk kanë qenë siç duhet, por ky takim ose kjo mbledhje ka për qëllim të pasurojë raportin që do t’i paraqitet seancës plenare, ndaj të gjitha mendimet unë i shikoj në këtë kuadër.

Gjej rastin t’i falënderoj të gjithë, edhe ministrat që raportuan këtu ose informuan për çështjet, edhe të gjithë kolegët deputetë, stafin e Kuvendit dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile për pjesëmarrjen! Sigurisht, këtu nuk keni ardhur me urdhër, por sepse këtë problem e ndieni. Për çdo problem, i madh ose i vogël qoftë, në radhë të parë, duhet të ketë ndjeshmëri për të. Të gjithë jeni prindër, unë jam gjysh, të tjerët kanë motra dhe vëllezër. Pra, nuk besoj se kushdo që është ose jo këtu të mos ketë ndjeshmëri për këtë çështje, por raporti nuk është qëllim në vetvete. Pra që t’i paraqitet seancës duhet të paraqesë të dyja anët: sa punë është bërë... Të mos themi që Shqipëria, siç thoshin në një kohë të kaluar, është kopsht me lule, këtë problem e ka ezauruar dhe e ka zgjidhur. Jo, ka shumë probleme dhe meqenëse ka shumë probleme, raporti duhet t’i evidentojë këto probleme dhe duhet t’i adresojmë këto probleme, jo se do t’i zgjidhim me këtë raport, pasi problemet janë të shumta.

Prandaj, unë mendoj që, sigurisht, nisur edhe nga mendimet që u dhanë këtu, ta pasurojmë raportin, por do t’i kushtoja veçanërisht rëndësi që seancës plenare t’i paraqitet një

rezolutë në mbështetje të këtij raporti, ku të adresohen problemet. Për shembull, marr spunto nga pyetjet që ngriti zoti Fino, edhe nga pyetjet që u ngritën veçanërisht nga koleget dhe kolegët e shoqërisë civile. Kur flas për rezolutë, e kam fjalën se çfarë duhet të bëjë Kuvendi në fushën legislative; çfarë duhet të bëjë ekzekutivi; çfarë duhet të bëjë pushteti vendor për këtë çështje; çfarë duhet të bëjë shoqëria civile. Të gjithë ne flasim për dhunë, por në shekullin kur unë jetova fëmijërinë time isha i mbrojtur, maksimumi që merrja ishte një pëllëmbë, ndërsa në shekullin që jetojnë fëmijët, për të cilët interesohemi, ka vare në kokën e tyre çdo ditë, çdo orë, çdo çast.

Çfarë do të thotë “vare”? Kemi disa kategori fëmijësh: kemi fëmijët jetimë, për të cilët sot shtrohet problemi, që ka një kategori që nuk janë gjëkund, ka një kategori që janë trajtuar nga shteti dhe kur u vjen mosha shteti nuk interesohet për një vend pune, por u thotë: “Dilni nga shtëpia e fëmijës”! Por ku do të venë?!

E shikoni sa i gjerë është problemi: që nga jetimi, i cili ngelet jetim si rezultat i nënës, i babait, i divorcit, apo jo, deri tek ai 18-vjeçari, i cili ka 18 vjet jetim dhe pastaj i themi: “dil në rrugë”?! Por ka edhe një kategori tjetër fëmijësh, prindërit e të cilëve janë fukarenj; janë nën minimumin jetik, që nuk u sigurojnë asgjë tjetër, është një kategori e gjerë, e madhe.

Të gjithë e ndjekin emisionin të “News 24-a”, atë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Shqiptarët për shqiptarët”, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A është shoqëria jonë tamam me filozofinë “Shqiptarët për shqiptarët” dhe, në radhë të parë për fëmijët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është?! Atëherë, çfarë do të mbrojmë?! Për cilën ndjeshmëri flasim?!

Ka një kategori tjetër: fëmijët me probleme, të cilëve natyra nuk u ka dhënë çfarë kanë të gjithë, por që, në fakt, duhet të jenë të barabartë me të gjithë.

Institucionet tona, shkollat tona, Kuvendi ynë, që thoni ju, të vijnë këtu... Me çfarë do ta sillni një fëmijë që është në karrocë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flisni për një zyrë ku do të ankohe... Me çfarë do ta çoni deri atje?

E gjithë shoqëria jonë nuk është konceptuar që të një projekt që miratohet, bie fjala, po nisem nga pyetja që bëri zoti Fino, se qysh kur miraton një ndërtesë, nuk e ka këtë kërkesë fare... Të gjithë janë me dorë e me këmbë, por ka fëmijë që nuk dëgjojnë, ka fëmijë që nuk

flasin. Është shtruar kërkesa tek unë, që kërkojnë të njihen me seancat plenare, por nuk kemi përkthyes.

E kam premtuar unë, por nuk është bërë ende si rezultat i moskoordinimit ndërmjet Kuvendit dhe Radiotelevizionit Publik, lëre më ato private, që nuk e kanë në konsideratë.

Vijmë te kategoria tjetër, e zengjinëve, që i kanë prindërit zengjinë, të cilët janë edhe më skandal. Ata nuk e kuptojnë se ç'po ndodh. Elektronika po bën punën e saj. Ajo që po ndodh me fëmijët sot, lum ne që jemi rritur në atë shekullin, ku vërtet nuk kishim për të ngrënë apo visheshim keq ose mungesa e higjienës ishte më e madhe, por para kësaj që ndodh sot me fëmijët, është një tmerr i vërtetë. Prindërit që vërtet janë zengjinë nga pikëpamja materiale, por që nga pikëpamja e të interesuarit për fëmijët e tyre janë gati t'ia lënë celularin hapur dhe vetëm aty, boll që nuk më shqetëson mua, në një njëfarë kuptimi, dhe dhjetë orë me celular para. Shohim pastaj që ka programe të tilla, që i kanë çuar pastaj në fenomene të ne që i kanë detyruar të kryejnë vetëvrasje, apo jo. Pra, a e kuptoni sa...? Përmenda në mënyrë telegrafike disa probleme që, siç thamë, problemet sot nuk janë kaq rozë sa duken, por shumë të ndërlikuara, janë shumë të gjera. Pastaj futemi te pjesa se çfarë është bërë me programet sociale nga Ministria e Shëndetësisë, çfarë bën Ministria e Arsimit lidhur me programet mësimore e të tjerë, por problemi është tejte i gjerë.

Prandaj, në këtë kuadër, unë do të thosha që është e nevojshme për ta parë në këtë këndvështrim një rezolutë të Kuvendit për të adresuar se çfarë duhet të bëjnë komisionet parlamentare lidhur me përmirësimet ligjore, për rrokjen e të gjitha këtyre kushteve, çfarë duhet të bëjë ekzekutivi për aktet normative dhe nënligjore në zbatim të këtyre ligjeve ose, ndershmërisht, të kontradiktave që kanë aktet normative të vjetruara ose të mosnxjerra për zbatimin e këtij legjislacioni; çfarë duhet të bëjë pushteti vendor, çfarë duhet të bëjë shoqëria civile, çfarë duhet të bëjë media, çfarë duhet të bëjë Avokati i Popullit, çfarë duhet të bëjë tjetri, tjetri e kështu me radhë për ta adresuar problemin dhe për të ngritur një shqetësim për të gjithë publikun, sepse këtë problem nuk mund ta zgjidhë një raport ose një rezolutë.

Shikoni, një emision që bën një herë në vit një televizion kombëtar me fëmijët dhe shikoni se çfarë pyetjesh u bëjnë personave që shkojnë atje. Për shembull, i thoshin “Gjinit”, megjithëse nuk e ka kështu emrin ai: “Ti je katundar. Kush është më i zgjuar, katundari apo qytetari? Ku është më mirë, në qytet apo në fshat?” “Gjini”, tani që është bërë prind, u thotë: “Ju lutem tani, se unë jam rritur te gjyshja, por do t’u rekomandoja të gjithë prindërve tuaj që t’i lënë celularët në shtëpi dhe t’ju çojnë çdo fundjavë te gjyshja në fshat, se do të shpëtoni!”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne patjetër duhet të adresojmë të gjithë problematikën në një rezolutë të Kuvendit për këto çështje.

Besoj që shumë shpejt ne do ta përfshijmë raportin në kalendarin e seancës plenare. Si kryesi na bie përgjegjësia që ta përgatisim këtë projektrezolutë, e cila mund të pasurohet edhe në seancën plenare. Nisur edhe nga pyetjet e zotit Fino, zotit Manja, ky është një problem që absolutisht çdo komision, çdo deputet në komisionin ku asiston duhet ta ketë në qendër të vëmendjes së të gjithë punës dhe veprimtarisë së tij për fushën që mbulon, për projektligjet që diskuton, që miraton dhe duhet ta trajtojë si problematikë.

Problemi i fundit që kam është që në datën 1 vendin tonë do ta vizitojë drejtoresha Rajonale për Europën dhe Azinë Qendrore e UNICEF-it, e cila ka shprehur dëshirën të bëjë një takim, kështu siç jemi ne sot, pra kur them “ne”, në radhë të parë, e kam fjalën për të gjithë deputetët e grupit “Miqtë e fëmijëve”. Në këtë mbledhje, siç jemi sot, ministrja e Arsimit, ministrja e Shëndetësisë, ministrja e Drejtësisë, ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, ministri i Brendshëm dhe ministrja e Financave të jenë në takim. Takimi do të zhvillohet në datën 1 prill këtë në këtë sallë, në orën 12:15.

Pra, problemi është i qartë. Nga sot dhe deri në atë ditë, të gjithë të jemi të gatshëm për të zhvilluar një bisedë për të gjithë problematikën, të cilën e diskutuam edhe sot. Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Atëherë, për raportin çfarë kisha për të thënë e thashë. Ka ndonjë vërejtje lidhur me kalendarin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk keni? Biem dakord?

(Deputeti Shameti ndërhyr pa mikrofon.)

Mirë, atëherë, punë të mbarë!

Vasilika Hysi – Më falni, mund të bëj një koment?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam vetëm një informacion.

(Diskutime në sallë)

Gramoz Ruçi – Mos u largoni, një sekondë!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Kam një informacion për njohje, në fakt, marr shkas edhe nga shqetësimi ose sugjerimi që ngriti zonja Felaj. Meqenëse ne kemi një marrëveshje me UNICEF-in, në Kuvendin e Shqipërisë është atashuar një këshilltare, profesoreshë Iva Zajmi,

të cilën e kemi edhe prezente, e cila është në dispozicion për të asistuar jo vetëm deputetët e grupit “Miqtë e fëmijëve”, por edhe çdo komision për çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve ose për qasjet që lidhen me shqetësimet që kemi në fushën e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka depozituar një raport të veçantë për punën e fëmijëve në Bashkinë e Bulqizës, ku, në emër të deputetëve, ka qenë zonja Klotilda Bushka, por kemi edhe një shënim nga Kryetari i Kuvendit, zoti Ruçi, i cili kryeson grupin “Miqtë e fëmijëve”, për të adresuar të gjitha shqetësimet që ka ngritur Avokati i Popullit, si dhe ka një sërë komisionesh që mund të investohen.

Gjithashtu, është depozituar një kërkesë nga organizata e CRCA-së lidhur me një dëgjese për raportin e parë për sigurinë në internet. Dy nënkomisionet përkatëse, që drejtohen nga unë në këtë grup, kanë zhvilluar një takim, ku ka qenë prezente edhe përfaqësuesja e Kuvendit, deputetja Ekonomi, lidhur me axhendën e zhvillimit, dhe deputetja tjetër, zonja Elena Xhina, ku janë marrë një sërë shqetësimesh dhe angazhimesh.

Po ashtu, është depozituar pranë grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve” dhe Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut një shqetësim i ngritur nga shoqata e sindromës “Down”, nga zonja Emanuela Pepkola Zaimi, për disa kërkesa që ka për Kuvendin. Për fat të mirë, dy nga kërkesat e saj janë adresuar: analiza e nënave me fëmijë me sindromën Down, dhe këtu do të doja ta falënderoja ministren, sepse do ta lançonin nesër, por njëkohësisht ka një sërë kërkesash që lidhen me Komisionin e Ligjeve, Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut, grupin e deputetëve, si dhe me Komisionin për Çështjet Sociale.

Një kërkesë tjetër vjen përsëri nga CRCA-ja lidhur me disa ndryshime në Kodin Penal për mbrojtjen e fëmijëve nga grabitqarët seksualë, nismë për të cilën ka pasur korrespondencë ndërmjet meje dhe ministres së Drejtësisë (letra dhe përgjigje), por ndërkohë besoj se ka nevojë për një angazhim nga Komisioni i Ligjeve.

Së fundi, në parlament janë depozituar disa kërkesa për dëgjesa ose informacion shtesë. Në këtë kuadër, është ajo që tha Kryetari, çdo komision dhe nënkomision mund të kontribuojë në adresimin e këtyre shqetësimeve. Do t’ju lutesha që të gjitha propozimet ose sugjerimet që do të keni për raportin, që mund të jenë harruar të pasqyrohen, të pasqyrohen brenda kësaj fundjave.

Njëkohësisht janë ftuar të gjithë këshilltarët ligjorë të komisioneve dhe të Shërbimit të Komisioneve, jo për të mbushur sallën, por sepse janë pikërisht ata që i këshillojnë deputetët në komisionet e tyre për të pasur ndjeshmëri lidhur me raportet që depozitohen te Kryetari i Kuvendit, i cili i përcjell të gjitha menjëherë. Ato shumëfishohen për deputetët, por

nuk e di sa mundësi keni pasur për t'i lexuar ose për të kërkuar zhvillimin e seancave dëgjimore, kërkesa për informacion për ministrat.

Ja ku i keni këshilltarët dhe stafin e Sektorit të Botimeve dhe të Studimeve në qoftë se do të keni nevojë për të bërë përmirësime të botimeve informuese për fëmijët në parlament. Të pranishëm këtu janë të gjithë drejtorët, këshilltarët ligjorë dhe stafi mbështetës.

Faleminderit për vëmendjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Hysi!

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen!

MBYLLET MBLEDHJA